



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport - Ministry of Culture, Youth and Sport

Nr.1521/2022

Datë: 25.11.2022

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019) bazuar në Rregulloren Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm z. Feim Hoxha, nxjerr këtë;

V E N D I M

1. Bazuar në kërkesën me numër të protokollit 3852/2022 të datës 30.08.2022, si dhe vendimin e Jurisë për vlerësimin e aplikimeve për logon e Operës së Kosovës në konkursin e shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, juria vlerëson se ky konkurs duhet të anulohet.
2. Juria për vlerësimin e aplikimeve për logon e Operës së Kosovës ka konstatuar se ky proces duhet të anulohet, në mungesë të kualitetit, konceptit, tregimit dhe veçantisë, prezantimit dinjitoz të identitetit të institucionit të Operës së Kosovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Kulturës;
- Operës së Kosovës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.



Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm